



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

NR. 2358 AKTI

NR. 1979 VENDIMI

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë,
me trup gjykues te perbere nga :

Gjyqtare ELVANA ÇIÇOLLI

asistuar prej sekretares gjyqësore Elona Dervishi, sot në datë 25.04.2016 mori në shqyrtim,
në seancë gjyqësore, çështjen me nr. 2328 Akti, që i përket:

PADITES : Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, (ne mungese)

E PADITUR : Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se
Pergjithshme te Tatimeve (ne mungese)

PERSON I TRETE: Tatimpaguesi Gjet Lleshi person fizik përfaqësuar nga
Z.Arben Lleshi.

Me njoftimin e Avokatures se Shtetit e cila ka depozituar relacionin
e mospjesemarrjes

OBJEKTI : Shfuqizimin e Vendimit nr.37832/1 prot, date 18/01/2016, te
Drejtorise Apelimit Tatimor Tirane. Lenien ne fuqi te aktit
administrativ me njoftim-vleresimin me nr.9441/27 prot date
29.10.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" dhe
Udhezimit nr.24 date 02.09.2008 i MF ne zbatim te tij. Ligjin
49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave
administrative dhe gjykimin e mosmareveshjeve administrative
ne RSH"

Gjykata pasi administroi provat e paraqitura dhe shqyrtoi kërkesë padinë:

V E R E N

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë me kërkesë padinë me objekt:

“Shfuqizimin e Vendimit nr.37832/1 prot, date 18/01/2016, te Drejtorise Apelimit Tatimor Tirane. Lenien ne fuqi te aktit administrativ me njoftim-vleresimin me nr.9441/27 prot date 29.10.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe.”

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesë padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 7, 8, 10, 11 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Ne baze te ekstraktit te leshuar nga Qendra Kombetare e Rregjistrimit, personi i trete “Gjet Lleshi” eshte i pajisur me nr Nipti L59510001P me ushtron aktivitet tregtar me objekt te veprimtarisë, “Bar kafe. Gomisteri etj...”

Inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe kane ushtruar kontroll ne sipas urdhërit të punës Nr.412 me date 14/09/2015, ëshlë ushtruar kontroll nga Inspektoret e DRT Lezhë dhe është mbajtur Akt Konstatimi Nr.0457341, datë 14/09/2015, ku pasqyrohet se:

“subjekti ushtron aktivitet dhe rezulton me shkelje ligjore, nuk ka dëftesë tatimore në mungese të kasës...”

Në vijim, tatimpaguesi është dënuar me gjobë në masën 50.000 lekë, bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 122, pika 1, gërma (b), nënparagrafi (i) dhe është njoftuar për njoftim-vleresimin me nr.9441/27 prot date 29.10.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe.

Personi i trete, i eshte drejtuar Drejtorise se Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve me shkresen me nr. 37832 prot, datë 20.11.2015 me objekt - anulimin e gjobës në masën 50.000 lekë për moslëshimin e kuponit tatimor (dëftesës tatimore), sipas Njoftim Vlerësimit nr. 9441/27 prot. datë 29.10.2015, nxjerrë nga DRT Lezhë.

Ne kete shkrese, subjekti i kontrolluar ka pretenduar se:

“Tatimpaguesi kërkon anulimin e gjobës duke parashtruar se në datat 12 dhe 14 shtator është paraqitur pranë DRT Lezhë për pajisjen me dëftesa tatimore, por nuk ka patur gjendje në drejtori. Pajisjen me dëftesa, tatimpaguesi e ka bërë në datën 15.09.2015 dhe parashtron se ka bërë rreth 500 km rrugë (3 herë vajtje ardhje në DRT Lezhë) për të marrë dëftesat tatimore.

Drejtoria e Apelimit Tatimor, e ka marre ne shqyrtim kerkesen dhe ne vendimin e saj Nr. 37832/1 prot, date 18/01/2016 nder te tjera ka arsyetuar se:

“Referuar fakteve dhe dispozitave të mësipërme, tatimpaguesi ka patur detyrimin për f u pajisur me dëftesën tatimore, në mungesë të pajisjes fiskale. Nga kontrolli i kryer është konstatuar se tatimpaguesi nuk është pajisur me dëftesa tatimore, por kontrolli nuk ka

konstatuar moslëshimin e dëftesës tatimore. Akti i konstatimit ka përshkruar vetëm faktin që tatimpaguesi nuk disponon dëftesën tatimore, por në momentin e kontrollit nuk është konstatuar kryerja e transaksionit me lekë në dorë....

Sa më sipër, Drejtoria e Apelit Tatimor çmon se tatimpaguesi duhet të dënohet me gjobë për mosmbajtjen e saktë të dokumentacionit, por jo për moslëshimin e dëftesës tatimore duke qënë se në momentin e kontrollit nuk është konstatuar kryerja e ndonjë transaksioni me lekë në dorë. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", neni 118, përcakton se "Tatimpaguesi, që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë me 10 000 lekë, për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si biznes i vogël, dhe me 50 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si, lloj tjetër biznesi."

Drejtoria e Apelit Tatimor, në zbatim të nenit 108, pikat 1 dhe 3, germa a, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Procedurat tatimore në R.Sh", dhe pikës 108.1 dhe 108.3.3 germa b të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24 datë 02.09.2008, i nxjerrë në zbatim të këtij ligji, me vendimin Nr. 32220/ Prot datë 18.01.2016 ka vendosur :

1. Lënien në fuqi të aktit administrativ, Njoftim Vlerësimit nr. 9441/27 prot, datë 29.10.2015, nxjerrë nga DRT Lezhë, për gjobën në masën 10.000 lekë për mosmbajtjen e saktë të dokumentacionit për periudhën 2015/10
2. Shfuqizimin e aktit administrativ, Njoftim Vlerësimit nr. 9441/27 prot, datë 29.10.2015, nxjerrë nga DRT Lezhë, për gjobën në masën 40.000 lekë

Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë e ka kundërshtuar vendimin e mesipër duke paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kerkese padine objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor.

➤ Pretendimet e pales paditese:

- Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin nr.37369/1 prot datë 15.01.2016 ka vendosur anulimin e aktit administrativ me arsyetimin se në periudhën Shtator 2015 nuk ka pasur Dëftesa Tatimore në Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhë, dhe këtë rast subjekti e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga ligjvënisi.
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", neni 54, pika 3 përcakton se "Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion". Ndërsa neni 55, paragrafi 1 përcakton se "Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor".
- Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", paragrafi 47.1.3 përcakton se "Personi i tatueshëm shitës me pakicë, tatimpaguesi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, për çdo shitje në njësitë e shitjes me pakicë, të kryer për

individuale konsumatore finale, është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me arke regjistruese dhe ne mungese të saj dëftesë tatimore". Ndërsa paragrafi 47.1.5 përcakton se "Dëftesa tatimore lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shitës me pakice tatimpaguesi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të cilët nuk janë të pajisur me arke regjistruese

➤ Pretendimet e personit të tretë

- Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. 37832/1 prot, date 18/01/2016 duhet të kishte shfuqizuar të gjithë Njoftim Vlerësimit nr. 9441/27 prot, datë 29.10.2015 nxjerrë nga DRT Lezhë, për gjobën prej 50.000 leke
- Tatimpaguesi kërkon anulimin e gjobës duke parashtruar se në datat 12 dhe 14 shtator është paraqitur pranë DRT Lezhë për pajisjen me dëftesa tatimore, por nuk ka patur gjendje në drejtori. Pajisjen me dëftesa, tatim paguesi e ka bërë në datën 15.09.2015 dhe parashtron se ka bërë rreth 500 km rrugë (3 herë vajtje ardhje në DRT Lezhë) për të marrë dëftesat tatimore.

Arsyetim ligjor

Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarive qeveritare e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e pëanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë. Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor i veprimtarisë administrative është të mbrojtë të drejtat e qytetarëve, por edhe të mbrojtë interesin publik dhe rendin ligjor. Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë.

Neni 106 I ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" parashikon se:

1. "Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor , , ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin"

Në këto kushte, me të drejtë, personi I tretë, në cilësinë e tatimpaguesit I është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke apeluar aktin administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore 9441/27 prot, datë 29.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë.

Nga ana e Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është marrë në shqyrtim ankimi dhe është shqyrtuar në bazë të ligjit 9632, datë 30.10.2006, I ndryshuar me ligjin Nr.85/2014, neni 16, miratuar në datë 17.07.2014.

Pala e Paditur Drejtoria e Apelit Tatimor ka gjykuar për shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ të kundërshtuar. Tatimpaguesi është ndeshkuar me gjobe në masën 500.000 leke, në bazë të Ligjit Nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 119, pika, a, për për moslëshimin e kuponit tatimor (dëftesës tatimore), sipas Njoftim Vlerësimit nr. 9441/27 prot. datë 29.10.2015, nxjerrë nga DRT

Lezhë.



Sipas nenit 9 të Kodit të Procedurave Administrative :

"Organet e Administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Marrëveshjet Ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që iu janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilin janë dhënë këto kompetenca;.."

Legjislatori i ka kushtuar parimit të ligjshmërisë një rëndësi të natyrshme që justifikohet nga rëndësia e marrëdhënieve të administratës me individët. Ky parim kërkon jo vetëm që autoritetet administrative të mos shkelin ligjin por edhe që të gjitha aktet e nxjerra prej tyre të jenë të autorizuar qartë nga ligji dhe përmbajtja e këtyre akteve të jetë në përputhje me atë ligj. Për më tepër, ky parim presupozon që përmbajtja e organeve administrative ndaj këtyre kërkesave të jetë e zbatueshme në praktikë.

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", neni 54, pika 3 përcakton se:

"Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimore për çdo transaksion". Ndërsa neni 55, paragrafi 1 përcakton se "Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor".

Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", paragrafi 47.1.3 përcakton se:

"Personi i tatueshëm shitës me pakicë, tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, për çdo shitje në njësitë e shitjes me pakicë, të kryer për individë konsumatore finale, është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me arke regjistruese dhe në mungesë të saj dëftesë tatimore".

Ndërsa paragrafi 47.1.5 përcakton se:

"Dëftesa tatimore lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shitës me pakicë tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të cilët nuk janë të pajisur me arke regjistruese.."

Me të drejtë Drejtoria e Apelimit Tatimor në vendimin e saj ka arsyetuar se, tatimpaguesi ka patur detyrimin për tu pajisur me dëftesën tatimore, në mungesë të pajisjes fiskale. Nga kontrolli i kryer është konstatuar se tatimpaguesi nuk është pajisur me dëftesa tatimore, por kontrolli nuk ka konstatuar moslëshimin e dëftesës tatimore.

Akti i konstatimit ka përshkruar vetëm faktin që tatimpaguesi nuk disponon dëftesën tatimore, por në momentin e kontrollit nuk është konstatuar kryerja e transaksionit me lekë në dorë.

Neni 121 i K.Pr.A parashikon mundësinë e shfuqizimit të akteve administrative relativisht të pavlefshme:

"Aktet administrative shfuqizohen ose revokohen me nismën e organit kompetent ose si rezultat i kërkesës për shqyrtim apo apelimit të palëve të interesuara.

Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk mund të shfuqizohen apo revokohen.

Doktrina ka sqaruar se:

Shfuqizimi është e drejta e organit epror administrativ që me anë të një akti të ri të ankim administrativ nga pala e interesuar me qëllim që të vihet në lëvizje organi kompetent për të zhvilluar procedurën përkatëse. Nisma e organit epror në këto raste nuk mund të realizohet, pasi duhet detyrimisht që të ketë një ankim nga dikush që të shfuqizohet akti i kundraligjshëm. Megjithatë nuk përjashtohen rastet kur organi epror që shfuqizon një akt të organit më të ulët, të shfuqizojë përveç këtij akti edhe aktet e tjera që mund të jenë marrë si rrjedhojë e aktit të shfuqizuar.

Shfuqizimi dhe revokimi aplikohet vetëm për aktet relativisht të pavlefshme të cilat janë akte që prodhojnë efekte juridike deri në momentin që atyre u pushon fuqia juridike. Është e qartë se aktet absolutisht të pavlefshme nuk mund të shfuqizohen apo revokohen, përse kohë ato, sipas kuptimit që i jep ky Kod dhe teoria në përgjithësi, nuk mund të konsiderohen akte. Një akt që është nul që në momentin që është nxjerrë dhe që konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar për asnjë çast, nuk mund të shfuqizohet dhe as të revokohet. Shfuqizimi dhe revokimi u bëhet akteve që kanë ekzistuar deri në momentin që u pushon kjo fuqi juridike. Organi kur ndeshet me akte të tilla ka për detyrë të rregullojë pasojat që akti absolutisht i pavlefshëm ka krijuar por në asnjë mënyrë të shprehet për shfuqizimin e një akti që nuk ka dhe as nuk mund të ketë patur ndonjëherë fuqi juridike.

Aktet administrative i pushojnë efektet e tyre ligjore, nëpërmjet deklarimit të një vullneti juridik nga organet përkatëse, të cilat e kanë një kompetencë të tillë. Ky deklarim vullneti kryhet me anë të nxjerrjes së aktit të ri juridik, i cili mund të revokojë, shfuqizojë, apo ndryshojë aktin e mëparshëm, të cilit nuk duhet t'i vazhdojnë më tej efektet e tij juridike.

Kur organi administrativ kompetent shqyrton vlefshmërinë e aktit që ka nxjerrë vetë ose të një organi më të ulët, duhet të ndjekë të njëjtën procedurë që ligji parashikon për nxjerrjen e aktit. Nxjerrja e aktit kërkon respektimin e të gjitha kërkesave ligjore, pasi përndryshe moszbatimi i këtyre kërkesave mund të sjellë pavlefshmërinë e aktit. Pra respektimi i formës së aktit, qëllimi i tij dhe veçanërisht arsyetimi janë elementë të domosdoshëm që duhet të respektohen edhe gjatë nxjerrjes së aktit revokues apo shfuqizues. Gjithashtu edhe procedura që fillon që me njoftimin e palëve të interesuara në aktin që po shqyrtohet, dëgjimi i pretendimeve që mund të kenë ndaj aktit të ankimuar etj, janë të domosdoshme për tu respektuar.

Marrja e një forme të caktuar të aktit revokues apo shfuqizues si dhe ndjekja e një procedure të caktuar krijojnë mundësitë e një shqyrtimi dhe zgjidhjeje të drejtë të çështjes si dhe njëkohësisht i japin të gjitha mundësitë palëve të interesuara që nuk janë dakort me zgjidhjen për ta dërguar çështjen në një organ tjetër administrativ ose përfundimisht në gjykatë. Pikërisht zbatimi i këtyre rregullave formale dhe proceduriale i shërbejnë edhe transparencës që është një nga parimet bazë që duhet të udhëheqë administratën tonë. Ky është rregulli i përgjithshëm që duhet të karakterizojë çdo organ administrativ që revokon apo shfuqizon një akt.

Njoftim vlerësimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe është një akt administrativ i cili pasqyron vullnetin shtetëror të këtij organi. Në këtë këndvështrim ai duhet të jetë në

përputhje me legjislacionin në fuqi. Një vendim administrativ i marrë në kundërshtim me ligjin duhet të konsiderohet si relativisht i pavlefshëm e për pasojë duhet të shfuqizohet.

Gjykata në keto kushte, çmon se akti administrativ, Vendimi nr 37832/1 prot, date 18/01/2016 i Drejtorisë se Apelit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve është një vendim i marrë në përputhje me ligjin.

Për pasojë kërkesë padia e paraqitur prej palës paditëse duhet të konsiderohet si e pambështetur në ligj e për pasojë duhet të rrëzohet.

Për shkak të parashikimeve të nenit 45/b të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative ky vendim është i paankimueshëm.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126, të Kodit të Procedurës Civile, nenit 40 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

VENDOSI

1. Rrezimin e kerkese padise me nr.2358 Akti me pale paditese DRT Lezhe.
2. Shpenzimet gjyqesore si jane kryer.
3. Ky vendim eshte I formës se prere.

U shpall sot ne Tirane, me date 25.04.2016!

SEKRETARE
ELONA DERVISHI

